Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 22 gusht 2012

Lënda nr. 45/08, LINDA, SH.P.K

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 22 gusht 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar në Panel më 12 nëntor 2008 dhe është regjistruar në të njëjtën datës.

2. Më 16 dhjetor 2008 dhe më 2 shkurt 2009, Paneli kërkoi nga ankuesi që të jep informata dhe dokumente shtesë. Përgjigja nga ankuesi është pranuar më 17 shkurt 2009.

3. Më 3 qershor 2009, Paneli ia komunikoi lëndën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në mënyrë që të merr komentet e UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës. PSSP-ja dha komentet më 24 qershor 2009.

4. Më 12 gusht 2009, Paneli ia dërgoi një letër ankuesit, duke e ftuar që të parashtrojë komentet e veta ndaj vërejtjeve të PSSP-së.

5. Më 19 nëntor 2009, Paneli ia rikomunikoi lëndën PSSP-së në mënyrë që të merrte komentet e UNMIK-ut për pranueshmërinë e lëndës, në dritën e Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 të datës 17 tetor 2009 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut. PSSP-ja dha komentet më 10 dhjetor 2009.

6. Më 2 janar 2010, Paneli ia dërgoi një letër ankuesit, duke e ftuar t'i parashtrojë komentet ndaj vërejtjeve të PSSP-së. Përgjigjet e ankuesit ndaj vërejtjeve të UNMIK-ut janë pranuar më 26 janar 2010 dhe më 22 shkurt 2010.

7. Më 20 shtator 2010 dhe më 14 shkurt 2011, Paneli u dërgoi letra Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, përmes të cilave kërkonte informata për vendimet e nxjerra lidhur me këtë çështje. Përgjigjet nga Gjykata Ekonomike e Qarkut janë pranuar nga Paneli, më 13 dhjetor 2010, 18 shkurt 2011 dhe 15 mars 2011.

8. Më 13 maj 2011, Paneli shpalli ankesën si të pranueshme.

9. Më 19 maj 2011, Paneli njoftoi PSSP-në për këtë vendim, dhe kërkoi komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e lëndës. Më 11 korrik 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

10. Më 24 gusht 2011, Paneli ia përcolli komentet e PSSP-së ankuesit, dhe ftoi atë që të parashtrojë komente të tjera. Më 11 nëntor 2011, Paneli morri komentet nga ankuesi.

11. Më 28 mars 2012, Paneli kërkoi informata shtesë nga PSSP-ja lidhur me bazueshmrinë e lëndës. Më 26 prill 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

12. Më 3 maj 2012, Paneli ia përcolli ankuesit komentet e PSSP-së.

13. Më 6 gusht 2012, Paneli morri informata shtesë nga ankuesi lidhur me lëndën.

II. FAKTET

14. Kompania ndërtimore Linda, Sh.p.k, më tutje në tekst "Linda", është kompani me përgjegjësi të kufizuar. Të gjitha aksionet e saj janë në pronësi të Milaim Berishës, i cili është gjithashtu edhe drejtor i kompanisë.

15. Më 26 qershor 2006, "Linda" nënshkroi kontratë me Zonën e komandës të Trupave të Mbrojtjes të Kosovës (TMK) për ndërtimin e objektit në fshatin Bardh i Vogël. Sipas ankuesit, në rastet kur është kryer puna dhe është pranuar teknikisht, TMK-ja ka mbajtur 10%-shin e çmimit të kontratës.

16. Më 25 gusht 2006, kompania e ankuesit ka nënshkruar kontratën e dytë me Zonën komanduese të kazermës ushtarake të TMK-së "Adem Jashari"për ndërtimin e objekteve ushtarake të Batalionit të 50-të. Ankuesi pretendon se TMK-ja ka paguar vetëm një pjesë të çmimit të kontratës dhe se padrejtësisht nuk ia ka paguar ankuesit disa pagesa.

17. Të dy kontratat janë nënshkruar me emblemën e UNMIK-ut.

18. Kryeadminstratori i TMK-së ka deklaruar se pagesat janë zbritur për shkak të vonesave në punët ndërtimore. “Linda” ka kontestuar deklaratën se kontrata parashihte zbritje të tilla, duke thënë se e vetmja bazë për çfarëdo mospagese do të ishte shtyrja e pagesës së 10%-shit të çmimit kontraktues si një garanci për punët ndërtimore për më së shumti një vit. “Linda” argumenton e çfarëdo vonese gjatë periudhës së ndërtimit ka qenë e arsyeshme dhe se punët janë pranuar teknikisht si të kënaqshme.

19. “Linda” ka parashtruar dy kërkesa për përmbarimin e kontratave në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, lëndët nr. 10/08 dhe E. nr. 11/08. Të dy kërkesat janë pranuar më 28 janar 2008, dhe formula e përmbarimit së bashku me tekstin e vendimit u janë bashkëngjitur atyre.

20. Pasi që Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë pranoi të dy kërkesat për përmbarim, Zyra për Çështje Ligjore (ZÇL) e UNMIK-ut, më 8 shkurt 2008 i shkroi letër kryetarit të Gjykatës. Në letër thuhej si në vijim:

> “Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) është një organizatë që vepron nën kontrollin dhe autoritetin e PSSP-së. Rrjedhimisht, këto raste përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me privilegje dhe imunitete të UNMIK-ut dhe të Kombeve të Bashkuara, për të cilat gjykatat e Kosovës nuk kanë juridiksion të vendosin. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut, si dhe të pjesëtarëve e punonjësve të tyre në Kosovë parasheh që UNMIK-u të gëzon imunitet nga çfarëdo procesi juridik në Kosovë. Në këto rrethana, kërkoj që Gjykata Ekonomike e Qarkut të deklarojë se nuk ka juridiksion ndaj këtyre çështjeve dhe që të heq propozimet për përmbarim nga regjistri i gjykatës.”

21. Më 17 korrik 2008, kompania “Linda” ia dërgoi një letër Gjykatës ekonomike të qarkut në Prishtinë, duke theksuar se kreditori nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje ndaj urdhrave për përmbarim. Rrjedhimisht, ka kërkuar nga Gjykata të merr vendimet për përmbarim lidhur me lëndët E. nr. 10/08 dhe E. nr. 11/08 tek banka kompetente në mënyrë që shumat përkatëse të mund të barteshin në llogarinë e tij.

22. Më 26 janar 2009, “Linda” ia dërgoi një letër tjetër Gjykatës ekonomike të qarkut në Prishtinë. Aty thuhej se pasi që kompetencat e Zyrës së koordinatorit të TMK-së i janë bartur Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, dhe pasi që TMK-ja si forcë mbrojtëse ishte shpërbërë dhe ishte themeluar Forca e Sigurisë e Kosovës, trashëgimtarja ligjore e Zyrës së koordinatorit të TMK-së ishte Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës në Prishtinë. Si rrjedhojë, më 20 shkurt 2009 Gjykata njoftoi Ministrinë e Drejtësisë për dy kërkesat për përmbarimin e kontratës, me formulën për përmbarim të bashkëngjitur në të.

23. Më 23 shkurt 2009, Ministria e Drejtësisë e Kosovës ia ka parashtruar Gjykatës ekonomike të qarkut në Prishtinë dy vërejtje, kundër vendimeve të lartpërmendura për përmbarim lidhur me lëndët nr. 10/08 dhe E. 11/08. Ministria e Drejtësisë deklaroi se Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës nuk ishte trashëgimtarja ligjore e TMK-së, por një institucion i ri i themeluar. Këto vërejtje janë regjistruar me nr. C. 62/2009, përkatësisht me nr. C. 61/2009.

24. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë ka lëshuar dy vendime: të parin, më datën 26 shkurt 2009, për lëndën nr. C. 62/2009, dhe tjetrin më 27 shkurt 2009, për lëndën nr. C. 61/2009. Në të dyja rastet Gjykata konstatoi se, duke pasur

parasysh kërkesën e bërë nga paditësi (supozojmë se i është referuar letrës së kompanisë "Linda", të datës 26 janar 2009), pala e paditur ishte Ministria e Forcës së Sigurisë e Kosovës. Më tej, Gjykata konstatoi se Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës ishte organ administrativ shtetëror, së cilës i mungonte kapaciteti i personit juridik. Në bazë të nenit 73.1 të Ligjit për procedurën kontestimore, vetëm personi fizik dhe juridik mund të jenë palë në procedurë. Neni 73.2 i këtij Ligji parasheh se përmes dispozitave të veçanta mund të përcaktohej se kush tjetër do të mund të ishte palë në procedurë, përveç personave fizikë dhe juridikë. Pala e paditur nuk ishte as person fizik e as juridik e as që ka qenë palë në procedurë përmes asnjë dispozite të veçantë. Për këto arsye, Gjykata ka revokuar vendimet e veta për lëndët E. nr. 10/08 dhe E. nr 11/08 dhe shpalli kërkesat fillestare si të papranueshme, për aq sa ato ishin të ridrejtuara kundër Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës.

25. Më 8 mars 2009, "Linda" u ankua kundër vendimeve për lëndët nr. C. 61/2009 dhe C. 62/2009. Këto ankesa janë regjistruar nga Gjykata Supreme me numrat nr. Ae. 153/2009, përkatësisht me Ae. 59/2009. Më 30 qershor 2009, përkatësisht më 21 shtator 2010, Gjykata Supreme refuzoi ankesat si të pabazuara. Sipas Gjykatës Supreme, Gjykata ekonomike e Qarkut në Prishtinë me të drejtë kishte vendosur që pala e paditur, gjegjësisht Ministria e Forcës së Sigurisë e Kosovës, nuk kishte kapacitetin e personit juridik dhe po ashtu në bazë të asnjë dispozite të veçantë nuk mund të konsiderohej si palë në procedurë.

26. Më 3 maj 2012, "Linda" është njoftuar përmes komenteve të PSSP-së, të datës 26 prill 2012, (shih më lartë, § 12) se kishte të drejtë që ankesën ta ngrinte para Bordit të UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave lokale.

27. Më 3 gusht 2012, ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Zyrës së koordinatorit të TMK-së tek Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave lokale.

III. ANKESA

28. Ankuesi ankohet për mospërmbushjen e obligimeve kontraktuale nga TMK-ja, për të cilat janë lëshuar edhe kërkesat për përmbarim nga Gjykata komerciale e qarkut në Prishtinë më 28 janar 2008. Nga ankesa gjithashtu del se ankuesi ankohet për imunitetin e dhënë TMK-së dhe mungesën e juridiksionit të gjykatave të Kosovës ndaj saj.

29. Paneli konsideron se mund të thuhet se ankuesi thirret në shkeljen e të drejtës për qasje në gjykatë, të garantuar përmes nenit 6 § 1 të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj). Po ashtu mund të konsiderohet se ankuesi thirret në shkeljen e të drejtës për mjet të efektshëm juridik (neni 13 i KEDNj-së), në kombinim me të drejtën në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNj-së).

IV. LIGJI

30. Në komentet e tij të parashtruara pas shpalljes së ankesës si të pranueshme, PSSP-ja ngritë dy vërejtje të reja lidhur me pranueshmërinë e ankesës. Fillimisht ai thotë se ankesa është parashtruar pas datës së efektshme të vërtetimit të imunitetit të tij nga UNMIK-u, dhe se rrjedhimisht është e papranueshme pasi që është parashtruar më shumë se gjashtë muaj pas periudhës së paparë. Së dyti, ai

argumenton se ankuesi nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Në veçanti, ai thotë se ankuesi është dashur të parashtrojë ankesë te Bordi i UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave lokale.

31. Para vazhdimit të shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli fillimisht duhet të konsiderojë vërejtjet e reja të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë në pajtim me nenin 2.3 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, të datës 17 dhjetor 2009 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut.

A. Rregulla e gjashtëmujorit

32. PSSP-ja thotë se ankesa duhet të jetë e papranueshme sepse është parashtruar më shumë se gjashtë muaj pas marrjes së vendimit të formës së prerë. Në veçanti, PSSP-ja shton se UNMIK-u ka nxjerrë vendimin e formës së prerë për këtë rast më 8 shkurt 2008, kur ia dërgoi vërtetimin për imunitetin e tij Gjykatës ekonomike të qarkut në Prishtinë. PSSP-ja argumenton se për shkak se ankuesi ka parashtruar ankesën në Panel më 12 nëntor 2008, në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 e njëjta është e papranueshme.

33. Paneli nuk pajtohet me këtë. Afati gjashtëmujor, i paraparë në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që ankuesit të parashtrojnë ankesat e tyre brenda gjashtë muajve nga marrja e vendimit të formës së prerë gjatë procesit të shterjes së mjeteve juridike në dispozicion. Për qëllime të llogaritjes së periudhës gjashtëmujore, mund të merren parasysh vetëm mjetet juridike të zakonshme dhe të efektshme pasi që ankuesi nuk mund të zgjasë afatin strikt të paraparë sipas Rregullores, duke tentuar të bëjë parashtresa jo të duhura apo të bazuara keq organeve ose institucioneve që nuk kanë autorizime apo kompetenca për të ofruar zgjedhje të efektshme të lëndës për ankuesin lidhur me çështjen sipas Rregullores (shih Panelin këshillëdhënës për të drejta të njeriut, *Thaçi*, nr. 13/08, vendim i datës 10 qershor 2011, § 37, shih gjithashtu lidhur me afatin gjashtëmujor, të paraparë në nenin 35 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj): Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Fernie kundër Mbretërisë Bashkuar*, nr. 14881/04, vendim i datës 5 janar 2006; GjEDNj, *Svenska Flygföretagens Riksförbund dhe Skyways Express AB kundër Suedisë*, nr. 32535/02, vendim i datës 12 dhjetor 2006; GjEDNj, *Sobczynski kundër Polonisë* nr. 355/04 dhe 358/04, vendim i datës 25 shtator 2007; GjEDNj, *Hysi kundër Shqipërisë*, nr. 38349/05, vendim i datës 26 shkurt 2008).

34. Më 12 nëntor 2008, data kur kompania e ankuesit ka parashtruar ankesën në Panel, lënda ishte ende nën procedurë para Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës, e cila kishte filluar më 28 janar 2008, dhe përfundoi me lëshimin e vendimit të dytë më 27 shkurt 2009. Po kështu, Gjykata Supreme refuzoi ankesat e ankuesit të datës 30 qershor 2009, përkatësisht të 21 shtatorit 2010. Si të tilla, Paneli konstaton se ankesat janë parashtruar me kohë. Kështu që Paneli hedh poshtë këtë vërejtje të ngritur nga PSSP-ja.

B. Shterja e mjeteve juridike në dispozicion

35. PSSP-ja më tej argumenton se ankuesi nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Më konkretisht, ai thotë se ai është dashur ta parashtrojë ankesën në

Bordin e UNMIK-ut për shqyrtimin e ankesave lokale, pasi që TMK-ja ka vepruar si organ i UNMIK-ut.

36. Neni 2.2 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 parasheh që çfarëdo ankese "që është apo mund të bëhet në të ardhmen" subjekt i Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta, që është e aplikueshme për UNMIK-un sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47, "konsiderohet si e papranueshme", për arsye se ky proces konsiderohet mjet juridik në dispozicion në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

37. Sipas nenit 3.1 të Rregullores nr. 2006/12 ankuesi duhet të ketë qasje normale në mjete të disponueshme dhe të mjaftueshme juridike për të ofruar zgjidhje përkitazi me shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaftueshmërisht i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, ku mosekzistimi i tyre do të paraqiste mungesën e qasshmërisë dhe të efektshmërisë (PKDNj, *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, vendimi i datës 31 mars 2010, § 45; PKDNj, *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, vendim i datës 31 mars 2010, § 35; krahaso lidhur me kushtin për shterjen e mjeteve vendore juridike sipas nenit 35 § 1 të KEDNj-së Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) (Dhoma e lartë), *Paksas kundër Lituanisë*, nr. 34932/04, aktgjykim i datës 6 janar 2011, § 75). Do të ishte normale që Paneli të pranojë se procesi i OKB-së për ankesat e palëve të treta, sikurse çdo mjet tjetër juridik që mund të zbatohet nga UNMIK-u "ishte i efektshëm, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në kohën e duhur, që do të thotë se ishte i qasshëm dhe që ka mundur të ofrojë zgjidhje lidhur me (ankesën e ankuesit), si dhe ka pasur mundësi të arsyeshme për sukses" (PKDNj, *Balaj dhe të tjerët*, § 45, dhe *N.M dhe të tjerët*, nr. 26/08 në § 35, duke iu referuar KEDNj-së *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykim i datës 16 shtator 1996, Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve, 1996. IV, f. 1211, § 68).

38. Përmes nenit 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 hiqet juridiksioni nga Paneli. Kjo dispozitë ka efektin e obligimit të Panelit që të konsideron Procesin e OKB-së për ankesat e palëve të treta si një mjet juridik të qasshëm dhe të mjaftueshëm.

39. Kjo nuk nënkupton se vetëm fakti i ngritjes së vërejtjes së UNMIK-ut, duke u bazuar në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative nr. 2009/1 pashmangshmërisht çon në përfundim që ankesa të konsiderohet e papranueshme. Paneli konsideron se kur ngrihet një vërejtje e tillë, duhet të vërtetojë nëse objekti i ankesës para Panelit është i asaj natyre që me arsye mund të ngrisë pretendim që mund të trajtohet përmes procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta. Paneli shpall ankesën të pranueshme vetëm atëherë kur konstaton se ankesa është e tillë që hyn *prima facie* brenda fushëveprimit të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta. Në këtë rast është e kundërta, përjashtohet nga shqyrtimi nëse rezultati i procesit mund të ofrojë zgjidhje të mjaftueshme lidhur me ankesën para Panelit apo nëse procesi ofron perspektivë të arsyeshme për sukses të ankuesve.

40. Procedura e paraparë përmes Rezolutës 52/247 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 17 korrik 1998 për "përgjegjësinë e palëve të treta: kufizimet kohore dhe financiare" (A/RES/52/247) dhe në nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, të datës 18 gusht 2000 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e UNMIK-ut, KFOR-it dhe të punonjësve e pjesëtarëve të tyre në Kosovë, të cekur në nenin 2.2 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, ia mundëson Kombeve të Bashkuara që sipas diskrecionit të saj të jep kompensime lidhur me ankesat për lëndime, sëmundje apo vdekje të personit,

si dhe për humbje a dëmtim të pronës që rrjedh nga veprat e UNMIK-ut, të cilat nuk janë ndërmarrë si rezultat i nevojës operacionale. Rrjedhimisht, ankesat për shkeljen e të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut nuk do të konsiderohen të papranueshme sipas nenit 2.2 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 nëse kanë rezultuar me lëndim, sëmundje apo vdekje të personit ose në humbje të pronës. Ankesat për shkeljet e të drejtave të njeriut që nuk kanë rezultuar me dëme të asaj natyre me rregull nuk do shkonin në kundërshtim të kushtit lidhur me shterjen e procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta.

41. Sa i përket vërejtjes së ngritur nga UNMIK-u për këtë lëndë, Paneli përkujton se ankesa e parashtruar ka të bëjë me mosplotësimin e nga TMK-ja të obligimeve të saj kontraktuale, nga njëra anë, dhe me imunitetin e dhënë TMK-së e mosekzistimin e juridiksionit të Gjykatave të Kosovës ndaj saj, nga ana tjetër.

42. Lidhur me pjesën e ankesës për mosplotësimin nga TMK-ja të obligimeve të saj kontraktuale që ka rezultuar me humbje apo dëmtim të pronës, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës hyn *prima facie* brenda fushëveprimit të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta, dhe rrjedhimisht konsiderohet e papranueshme.

43. Pjesa tjetër e ankesës ka të bëjë me veprat, lëshimet ose situatat që qartazi nuk kanë rezultuar me lëndime, sëmundje apo vdekje të personit e as në humbje a dëmtim të pronës. Si të tilla, këto pjesë të ankesës rrjedhimisht nuk janë të mbuluara në kuadër të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta.

44. Megjithatë Paneli konsideron se të dy pjesët e ankesës dërguar Panelit janë aq të ndërlidhura sa që ndarja e tyre do të ishte artificiale, duke rezultuar me trajtimin e një ankese brenda Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta dhe me trajtimin e njëkohshëm të tjetrës nga Paneli (shih PKDNj, *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, at § 52; PKDNj, *N.M dhe të tjerët*, nr. 26/08, at § 42).

45. Paneli rrjedhimisht konsideron se e tërë ankesa konsiderohet e papranueshme.

C. Efektet e përcaktimit që ankesa të konsiderohet e papranueshme

46. Paneli konsideron se do të ishte e dobishme të shpjegohen efektet e vendimit të tij për mospranueshmërinë e ankesës.

47. Kushti për shterjen mjeteve juridike në dispozicion për nga vet natyra e tij është kufizim i përkohshëm i pranueshmërisë. Efekti i shpalljes së papranueshmërisë për shkak të mosshterjes së mjetit juridik në dispozicion në parim është i natyrës shtyse të afatit dhe jo i natyrës përfundimtare. Kjo do të thotë se ankuesi mund të riparashtrojë ankesën e tij pas përfundimit të të gjitha proceseve të nevojshme.

48. Megjithatë, nëse nga kompania e ankuesit kërkohet që të riparashtrojë ankesën pas përfundimit të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta, kjo do ta ndalonte parashtrimin e kësaj ankese përtej afatit të Panelit për parashtrimin e ankesave të reja, i cili ishte 31 mars 2010 (shih nenin 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1). Kushti për kalimin nëpër Procesin e OKB-së për ankesat e palëve të treta në atë rast do ta shuante ankesën dhe nuk do të ofronte mundësi që ankuesi t'ia riparashtrojë ankesën Panelit, përkundër faktit se Paneli më 13 maj 2011 konstatoi se ankesa ishte e pranueshme sipas kornizës rregullative në fuqi ë kohën kur është parashtruar. Një rezultat i tillë do të shkonte në dëm të nocioneve bazë të drejtësisë.

49. Në raste të ngjashme Paneli ka vendosur se duhet të jetë në dispozicion "procedura e posaçme" në mënyrë që ankuesit t'i jepet mundësia e riparashtrimit me kohë te Paneli pas përfundimit të përpunimit të ankesës së tij në kuadër të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta (shih PKDNj, *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, i cekur në § 37 më lartë, në §§ 55-61; PKDNj, *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, i cekur në § 37 më lartë, në §§ 45-51). Paneli zbaton qasje të njëjtë për këtë lëndë.

50. Rrjedhimisht, Paneli vendos në përputhje me rregullën 49 të Rregullores së punës të Panelit – e cila parasheh që çështjet që nuk rregullohen përmes kësaj Rregulloreje të punës i rregullon Paneli - që pas përfundimit të Procesit të OKB-së për ankesat e palëve të treta, kompania ankuese mund të kërkojë nga Paneli që të rihapë procedurat e tanishme. Në bazë të informatave që atëherë do t'i ketë në dispozicion, Paneli do të vendosë nëse duhet të pranojë atë kërkesë apo jo.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

SHPALL ANKESËN SI TË PAPRANUESHME.

Andrey ANTONOV	Marek NOWICKI
Zyrtar ekzekutiv	Kryesues